



Loret Sadiku ka pergenjeshtruar zerat per refuzimin e bere prej tij per miqesoren me Bjellorusine. Emri i tij ishte ne listen e De Biazit por u hoq per shak te nje demtimi. Mediat spekuluuan per kete ndryshim duke aluduar se ai e ka refuzuar Shqiperine por mbrojtesi ka sqaruar gjithcka duke treguar se nuk e ka cuar kurre ne mend dicka te tille. “Nuk jam grumbulluar me Kombetaren pasi jam i demtuar. Nuk eshte e vertet qe une po e prese Suedine. Kam probleme me muskujt e pjeses se siperme te kembes se majte, dhe do te jem jashte fushes per 2-3 jave”, ka theksuar Sadiku duke hedhur poshte te gjitha fjalet e kota per te.